

## KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 10 Gusht 2021, u paraqitën personalisht palët kontraktuese si më poshtë:

- **Z. Vasil Mero**, shtetas shqiptar, i lindur në Gjirokastrë dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 25.03.1952, i identifikuar nga Letërnjoftimi me Nr. 027846218 dhe Nr. Personal F20325020R, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë "Albanian Distribution Company ADC" SH.P.K. me NUIS: L52104227K, me adresë të selisë qendrore: Rruga Themistokli Gërmenji, Pallati 4, Tiranë, Shqipëri, që këtu e më poshtë do të quhet "**Shitësi**".

dhe

- **Z.Theodhoro Çami**, shtetas shqiptar, lindur më 06.09.1981, në Gjirokastrë dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridikë për të vepruar, i identifikuar nga Letërnjoftimin me Nr. 029033126 dhe Nr. Personal: I10906013F, që këtu e më poshtë do të quhet "**Blerësi**".

Palët bazuar në nenin 73/1/b të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" – i ndryshuar, nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe statutin e shoqërisë "Albanian Distribution Company ADC" SHPK, lidhin këtë "kontratë për shitje kuotash" si më poshtë vijon:

### Neni 1 Objekti i kontratës

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është shitja, nga Shitësi tek Blerësi, e 100% (njëqind përqind) të pjesëve/kuotave të kapitalit, që Shitësi zotëron në shoqërinë "Albanian Distribution Company ADC" SH.P.K me nr. NUIS: L52104227K.
- 1.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, struktura e pronësisë mbi kapitalin themeltar të shoqërisë do të jetë:

Ortakët	Numri i Kuotave	Përqindja e pronësisë mbi Kapitalin
<b>Theodhoro Çami</b>	<b>1</b>	<b>100%</b>

### Neni 2 Çmimi i shitjes

- 2.1 Çmimi total i shitjes që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi është **EU 30,000 (tridhjetë mijë) Euro**. Në qoftë se çmimi i shitjes do të paguhet në monedhën

vendase 'Lekë', kursi i këmbimit do të jetë ai i Bankës së Shqipërisë në ditën e ekzekutimit të pagesës.

### **Neni 3 Mënyra e pagesës**

- 3.1 Palët deklarojnë se çmimi i shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate, do të paguhet me transfertë bankare.
- 3.2 Banka ku duhet të realizohen pagesat me të gjitha komisionet përkatëse është si më poshtë

Banka: [●]  
Nr. Llog: [●]  
IBAN: [●]  
SWIFT: [●]

### **Neni 4 Detyrimet e shitësit**

- 4.1 Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 2, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së pjesëve/kuotave së kapitalit objekt të kësaj kontrate, që ai kishte në shoqërinë "Albanian Distribution Company ADC" SHPK, kuota/pjesë të cilat tashmë i kalojnë Blerësit.
- 4.2 Shitësi garanton se kuotat/pjesët e tij në kapital, nuk janë lënë peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar e gëzon të drejta të plota mbi të.
- 4.3 Shitësi garanton blerësin se i ka vënë në dispozicion Blerësit të gjithë dokumentacionin financiar dhe ligjor në mënyrë që blerësi të njihej me gjendjen financiare dhe ligjore të shoqërisë.
- 4.4 Shitësi mban përgjegjësi për çdo detyrim që shoqëria ka kundrejt të tretëve sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar deri në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate. Pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, secila prej palëve do të përgjigjet kundrejt detyrimeve të të tretëve sipas pjesëmarrjes respektive në kuotat e kapitalit themeltar në përputhje me parashikimet e nenit 68 të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- 4.5 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi pjesët e kapitalit objekt të kësaj kontrate.
- 4.6 Shitësi do të marrë të gjitha masat për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve të marra prej tij në bazë dhe për zbatim të kësaj kontrate.

**Neni 5**  
**Detyrimet e Blerësit**

- 5.1 Blerësi do të paguajë çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 2 të kësaj kontrate.


**Neni 6**  
**Dispozita Kalimtare**

- 6.1 Kjo kontratë përgatitet në 2 kopje në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.
- 6.2 Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.
- 6.3 Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.
- 6.4 Kjo kontratë rregullohet nga legjislacioni shqipëtar në fuqi.
- 6.5 Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**SHITËSI:**

**Z. Vasil Mero**

(Vasil Mero)



**BLERËSI:**

**Z. Theodhoro Çami**

